



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. 2-D/DPK Nr. Prot. 01-474/15
 Dep. Prot. No. 01-474/15
 Nr. I faq. 03 Data 23.02.2015
 Broj stranica 03 Datum 23.02.2015
 Nr. pages 03 Date 23.02.2015

Republika e Kosovës



Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATE/A:	23/02/2015
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Burim REÇICA, Drejtor i Prokurimit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
CC:	z. Veton FIRZI, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Dragashit”



I nderuar z. REÇICA,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Dragashit” me numër prokurimi: 207/14/096/511. Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik: “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Dragashit” me numër prokurimi: 207/14/096/511, në mënyrë që i njëjti të anulohet dhe të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042.

A r s y e t i m

Për rastin me nr. protokolli: DPKPP 03-03-175/15

Autoriteti Kontraktues, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në nevojën për Ndërtimin e Palestrës Sportive në Komunën e Dragashit, ka paraparë aktivitetet prokurimi me Procedurë të Hapur. Aktiviteti i prokurimit është shpallur më datë: 09/10/2014 në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik.

Për tenderin e lartë cekur, Autoriteti Kontraktues ka ftuar Agjencinë Kundër Korrupsion që të monitoroj punën e Komisionit Vlerësues. Nga data 02/02/2015 deri më 09/02/2015 përfaqësues nga Agjencia Kundër Korrupsion kanë qenë pjesë e monitorimit në Komisionin Vlerësues, të cilët kanë konstatuar se vlerësimi i Ofertave ishte në përputhje të plotë me ligjin e Prokurimit Publik si dhe me Dosjen e Tenderit. Gjatë monitorimit të procesit të vlerësimit, Agjencia Kundër Korrupsion ka hasur në disa formulime të kërkesave në Dosjen e Tenderit, të cilat lënë hapësirë për tu mos interpretuar vetëm në një mënyrë.

Në Dosja e Tenderit, tek “Para Masa dhe Para Llogaria” në pikë D, Ajrosja dhe Ventilimi kërkohej: **“Klima – Komora (AHU) për montim të jashtëm me dimensione për përgatitjen e ajrit dhe ventilimit, me ajër të freskët dhe rekuperator pllakor, prodhues Klima - Oprema, Kroaci, tip: KU 9-M-DU50P-S”**, pos saj në mesin e shumë kërkesave të tjera kërkohej edhe **“Furnizimi dhe montimi me klima pajisja kanalore prodhim DAIKIN modeli: FBQ100C8-RZQG1008V1”**. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik. Me caktimin e vendit të Origjinës si dhe emrin e prodhuesit të Klimës, Autoriteti Kontraktues ka favorizuar prodhuesin e caktuar, duke i diskriminuar të tjerët në raport me favorizuesin.

Po ashtu, në Dosja e Tenderit, Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FTD), Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare në pikën 8.2, kërkohet që: Pasqyrat Financiare të dëshmohen të audituara nga ndonjë firmë e njohur e licencuar për auditim, **apo auditor i pavarur i licencuar** të bashkangjitur certifikatën e auditorit (kopje). Bazuar në Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktues për Kriteret e Përzgjedhjes, tek rubrika Gjendja ekonomike dhe financiare si kërkesat minimale të gjendjes ekonomike/financiare mund të kërkohej: Kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporteve të menaxhmentit të certifikuara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion. Por assesi nga Auditor i pavarur dhe i licencuar i Auditimit.



Ajo çka mbetet shqetësuese për Agjencinë Kundër Korrupsion në lidhje me këtë tender janë çmimet jo normalisht të ulëta dhe çmimet jo normalisht të larta. Autoriteti Kontraktues para se të inicioj një aktivitet prokurimi, duhet ta analizoj mirë situatën e aktivitetit në fjalë. Po ashtu ka për detyrë të parashoh trendët e realizimit jo të mirë të punëve. Në këtë kontekst, nëse Autoriteti konsideron se kanoset rreziku për mos ekzekutimin e kontratës, duhet të sigurohet që përqindja e sigurimit të ekzekutimit është e mjaftueshme për mbulimin e dëmeve, në rast të mos realizimit të kontratës në fjalë. Gjithashtu preferohet që Autoriteti Kontraktues të bëjë referenca negative për Operatorët Ekonomik, që paraprakisht nuk kanë ekzekutuar kontratën në tërësi.

Gjatë monitorimit të vlerësimit të ofertave, Agjencia Kundër Korrupsion ka vlerësuar, krahasuar dhe ekzaminuar dokumentacion relevant dhe në bazë të të gjeturave, Agjencia konstaton se asnjëri nga Operatorët Ekonomik Ofertues nuk i ka plotësuar në tërësi kërkesat që janë paraparë në Dosjen e Tenderit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, si dhe me Pikën 23, Kriteret e Përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

Agjencia Kundër Korrupsion i rekomandon Autoritetit Kontraktues anulimin e këtij aktiviteti të prokurimi. Në rast të Ri Tenderimit, të përpilohet Dosja në mënyrë më të përshtatshme duke u bazuar në rekomandimet që dalin nga ky Opinion i Agjencisë, për të mos i lënë hapësirë tendencave manipuluese nga Operatorët Ekonomik.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !